



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 92 datë 27.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR INDIVIDË/FAMILJE QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE NGA BUXHETI I SHTETIT DHE BASHKIA GJIROKASTËR NË 2025, PASI E KANË TË VËSHTIRË TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË”.

Në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 „Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; neni 39, pika 3 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas programit social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor”, VKM nr. 362 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij“, VKB-së, Nr 71, datë 31.10.2024 “Për Miratimin e Vlerës Maksimale të Subvencionimit të Qirasë dhe të Nivelit të Qirasë në Treg të Lirë”, Proces-Verbalin e Komisionit të Strehimit, datë 16.12.2024, Nr 11429 prot, “Për Miratimin e Vlerës si dhe Listës së Përfituesve për Programin e Subvencionimit të Qirasë në Tregun e Lirë nga Fondet e Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Gjirokastrë”, Këshilli i Bashkisë, Gjirokastrë, më datë 27/12 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI.

- 1- Miratimin e listës së individëve/familjeve dhe vlerën e subvencionit të qirasë
- 2- Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare) dhe vlera financiare përlllogaritët që nga dita e lidhjes së kontratës së qirasë.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

ETLEVA YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

MERITA ISARAJ

